



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Data	16.09.2019	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	109/02-30502 ✓
		Shtojcë	



Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2019

Raporti i punës së KKSBB –së për 6 mujorin e parë 2019

Takimi i parë i KKSBB për vitin 2019 është mbajtur me 19 shkurt të këtij viti, këtë takim e ka udhëhequr Kryetari i Komunës, ndërsa për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar Komandanti i Stacionit të Policisë. Ai raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2018 , dhe krahasuar me vitin paraprak(2017) u tha se ka pasur ulje të veprave kriminale .

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime :

- 1.Të punohet bashkërisht në luftimin e dukurive negative
- 2.Të hulumtohen hapësira për parkingje
- 3.Të bëhet selektimi i punëve të kryera të nxjerra nga rekomandimet e vitit të kaluar
- 4.Të intervenohet në hendeqet e krijuara nëpër disa rrugë
5. Kompania KEDS të tregoj seriozitet në punën e tyre
- 6.Të mos pengohen iniciativat e mira të qytetarëve nga zyrtarët komunal
- 7.Kompania „Pastërtia” të kryejë shërbimin e duhur ndaj qytetarëve.

Monitorues në këtë takim ishin përfaqësues nga OSBE .

Takimi i dytë i KKSB është mbajtur më **17.04.2019**. Takimi është kryesuar nga Nënkryetari i Komunës dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve .

Për herë të parë në këtë takim prezantoi Komandanti i ri i Stacionit Policor Halim Shehu i cili kërkoi bashkëpunim të mëtutjeshëm me të gjithë arteret e sigurisë në komunën tonë si dhe raportoi mbi gjendjen e sigurisë dhe mbi planin operativ të këtij stacioni.

Rekomandimet e nxjerra nga ky takim ishin:

- 1.Kërkohet bashkëpunim edhe më i mirë i institucioneve të sigurisë
- 2.Të shfrytëzohen oborret e shkollave nëse paraqitet nevoja për parkingje në sezonin e verës.
- 3.Të merren masa në parandalimin e përhapjes së dukurisë së vjedhjes.
- 4.Të parashihet buxhet edhe më i madh për rastet emergjente
5. Të krijohet një grup i përbashkët nga anëtarët e KKSB-së dhe Komunës për evidentimin e rasteve më urgjente për të intervenuar në teren
6. Të vendosen barrierat dhe shenjat e komunikacionit aty ku është e arsyeshme për tu vendosur.

Këtë takim e monitoruan përfaqësues nga MAPL dhe nga Inspektorati i Policisë së Kosovës .

Më datë 19. 06 2019 është mbajtur takimi i tretë me radhë KKSB-së, të cilin e kryesoi Nënkryetari i Komunës ku prezent ishte edhe Kryetari i komunës Besim Ilazi.

Në këtë takim kryesisht u diskutua në lidhje me përgatitjet që janë bërë për sezonin verorë si dhe u diskutua rreth gjendjes së sigurisë në komunën tonë. Në bazë të asaj që u dëgjua nga Komandanti i Policisë , në periudhën në mes dy takimeve ka rezultate të mira në zbulimin e veprave kriminale dhe u apelua që gatishmëria e institucioneve të sigurisë për përballimin e sfidave të jetë edhe më i madh .

Në fund të këtij takimi janë nxjerrë edhe rekomandime të cilat ishin :

- 1.Të merren masa paraprake për sezonin e verës (parandalimin e zjarreve, ndotja akustike , parkingjet ilegale, ndotja e ambientit, prerja ilegale e pyjeve etj) .
- 2.Të bëhet meremetimi i rrugëve të dëmtuara
- 3.Përkushtim edhe më i madh në zbulimin e rasteve të vjedhjeve

Monitorues në këtë takim ishte përfaqësuesi i OSBE-së

Të gjitha takimet e mbajtura të KKSBB-së gjithashtu janë publikuar në web. faqen e Komunës.

Kaçanik .07.2019

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

